VENDIM
Nr.82, datë 27.11.2006

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA "AMAL" SHPK PËR PERIUDHËN 1 JANAR 2006 DERI NË 31 DHJETOR 2006

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa b, 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve "Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël", Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 27.11.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga "Amal" sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2006 deri më 31 dhjetor 2006,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga "Amal" sh.p.k., për periudhën 1.1.2006-31.12.2006, të jetë 4.14 lekë/kwh.
2. Ngarkohet "Amal" sh.p.k. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta